

ALB



OFFICE OF THE COMMISSIONER GENERAL FOR REFUGEES AND STATELESS PERSONS

# E drejta për t'u dëgjuar

Broshura për prindërit e  
shoqëruar nga fëmijë minorenë

.be

Responsible publisher:  
Dirk Van den Bulck, Commissioner General  
for Refugees and Stateless Persons

This brochure is also available  
in Dutch, French, English, Albanian,  
Pashto, Russian.

These different language versions can be found on:  
[www.cgrs.be/en/publications](http://www.cgrs.be/en/publications).

Updated: May 2019

# PËRMBAJTJA

---

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR PËR PRINDËRIT E SHOQËRUAR NGA FËMIJË MINORENË . . . . .	4
1. ÇFARË ËSHTË NJE KERKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE ? . . . . .	6
2. INTERVISTA PERSONALE NE CGRA . . . . .	8
3. CILAT JANË VENDIMET E NDRYSHME TE MUNDSHME ? .10 ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT . . . . .	11
ÇFARË DO TË THOTË « MBROJTJE NDËRKOMBËTARE » .12	
4. TE DREJTAT E FEMIJËVE . . . . .	14
5. FËMIJËT QË JU SHOQËROJNË DËSHIROJNE GJITHASHTU TË FLASIN VETË PËR PROBLEMET DHE FRIKËN E TYRE . . . . .	16
DUHET TE BËJNË ? . . . . .	17
A FTOHET FËMIJA ÇDO HËRË PËR NJË INTERVISTË NË QOFTË SE AI E BËN KËRKESËN ? . . . . .	17
6. INTERVISTA ME BASHKËPUNËTORIN E CGRA . . . . .	18
KU DO TË SHVILLOHET INTERVISTA ME BASHKËPUNËTORIN E CGRA ? . . . . .	19
SI ZHVILLOHET INTERVISTA E FËMIJËS TUAJ ME BASHKËPUNËTORIN E CGRA ? . . . . .	20
KUSH ËSHTË PREZENT NË INTERVISTË ? . . . . .	21
A NDJEKIM GJITHMONË DËSHIRAT E FËMIJËVE ? . . . . .	22
NJË INTERVISTË E MËVONSHME ËSHTË E MUNDUR . . . . .	22
FËMIJA JUAJ ËSHTË I THIRRUR PËR NJË INTERVISTË NË KOMISARIAT NDËRSA AI NUK E KA BËRË KËTË KËRKESË . . . . .	23
7. VENDIMI . . . . .	24

**E drejta për  
t'u dëgjuar  
për prindërit e  
shoqëruar nga  
fëmijë minorenë**

---

# E DREJTA PËR T'U DËGJUAR : BROSHURA PËR PRINDËRIT E SHOQËRUAR NGA FËMIJË MINORENË NË KUADRIN E PROCEDURËS SË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE PËRPARA CGRA

---

Zonjë, Zotëri,

Ju keni bërë një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare tek autoritetet belge. Ju jeni të shoqëruar nga një ose shumë fëmijë minorenë mbi të cilët ju ushtroni një autoritet prindëror. Ju e merrin këtë broshurë sepse kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare i përket gjithashtu fëmijëve minorenë që ju shoqërojnë. Kjo broshurë shpjegon se çfarë do të thotë kërkesa për një mbrojtje ndërkombëtare për këto fëmijë. Ata marrin gjithashtu një broshurë e cila ju shpjegon se çfarë do të thotë një mbrojtje ndërkombëtare për to.

E drejta për t'u dëgjuar për prindërit e shoqëruar nga fëmijë minorenë



ÇFARË ËSHTË  
NJË KËRKESË  
PËR MBROJTJE  
NDËRKOMBËTARE ?

---

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT



# ÇFARË ËSHTË NJË KËRKESË PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE ?

---

Ju kërkoni mbrojtjen tek autoritetet belge sepse keni pasur ose keni frikë te keni probleme të rënda ne shtetin tuaj të origjinës. Kjo është arsya që ju mendoni se nuk mund të ktheheni në shtetin tuaj. Ju e keni bërë kërkesën në Zyren e të huajvë. Nëse nuk keni kërkuar mbrojtje në një shtet tjetër, kërkesa do të dërgohet në CGRA, i cili do të shqyrtojë kërkesën e mbrojtjes ndërkombëtare. Komisariati i pergjithshëm për refugjatët dhe apatridët (CGRA) do t'ju thërres për një **intervistë personale** që t'ju lejojë të shpjegoni se përse keni pasur ose keni frikë të keni probleme.

WHAT IS AN APPLICATION FOR INTERNATIONAL PROTECTION ?



## INTERVISTA PERSONALE NE CGRA

---

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT



# INTERVISTA PERSONALE NË CGRA

---

Mbas transfertës të dosjes tuaj nga Zyra e të hujve, CGRA ju thërret për një intervistë personale. Bëhet fjalë për një intervistë në të cilën mund ti shpjegoni një bashkëpunëtori të CGRA për çfarë arsye/sh jeni larguar nga vendi juaj dhe përse nuk mund të ktheheni në vendin tuaj. Bashkëpunëtori i CGRA është një person që shqyrton kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Gjatë kësaj interviste personale, do t'ju bëjnë pyetje në lidhje me arsyen/t që ju ndalon/jnë të ktheheni në vendit tuaj. **Ju si person që ushtroni autoritetin prindëror, jeni gjithashtu përgjegjës për fëmijët që ju shoqërojnë. Ju e dini më mirë se si ti mbroni të drejtajt e fëmijëve tuaj. Kjo do të thotë që gjatë intervistës personale në CGRA, ju duhet ti tregoni problemet që keni pasur për fëmijët që ju shoqërojnë, ose arsyet për të cilat fëmijët tuaj nuk mund të kthehen në vendin tuaj.**

Në bazë të deklaratave tuaja, CGRA do të marrë një vendim të vetëm për ju dhe për fëmijët minorenë që ju shoqërojnë. Fëmijët e rritur që ju shoqërojnë kanë gjithashtu dosjen e tyre individuale në kuadrin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe do të ftohen gjithashtu në një intervistë personale.



## CILAT JANË VENDIMET E NDRYSHME TË MUNDSHME ?

---

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT

# CILAT JANË VENDIMET E NDRYSHME TË MUNDSHME ?

Belgjika ofron dy forma mbrotjeje : **statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtësues.**

## ÇFARË ËSHTË NJË REFUGJAT

Belgjika e ka firmosur Konventën e Gjenevës. Do të thotë që është një traktat ndërkombëtar. Nëpërmjet firmosjes të këtij traktati, Belgjika është e detyruar të ofrojë një mbrojtje personave që janë të persekutuar ose që kanë frikë nga persekutimet në rast se kthehen në vendin e tyre. Mund të jenë të persekuatuar për shumë arsye, domethënë :

- Për opinionet e tyre politike
- Për fënë e tyre
- Për racën e tyre
- Për shtetësinë e tyre
- Për përkatësinë në ndonjë «grup social». Nga «grup social» nënkuptojmë një grup personash të cilët e ndajnë një karakteristikë të pandryshueshme. Shumica e banorëve të shtetit tuaj ose të autoriteteve të shtetit tuaj trajtojnë në mënyrë armiqësore personat që prezantojnë këto karakteristika. Për shëmbull, një person është i persekutuar sepse është homoseksual.

Nëse, për një ose për shumë nga këto arsye, ju ose fëmijët që ju shoqërojnë e keni lëshuar vendin tuaj ose nuk mund të ktheheni, ju mund të merrni statusin e refugjatit në Belgjik.

## ÇFARË DO TË THOTË

### « MBROJTJE NDËRKOMBËTARE »

---

Në qoftë se ju nuk e merrni statusin e refugjatit për shkak të situatës tuaj, CGRA e shqyrton nëse ju plotësoni kushtet e nevojshme për të përfituar nga statusi i mbrojtjes plotësuese.

CGRA jep një mbrojtje plotësuese nëse ju rrezikoni të keni cënime të rënda në rast të kthimit në vendin tuaj.

Cënimet e rënda janë, për shëmbull :

- Dënimi me vdekje ose ekzekutimi,
- Tortura ose trajtime çnjerëzore ose degraduese,
- Një kërcënim i rëndë për jetën tuaj në rast lufte ose luftë civile.

Mbas shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, CGRA mund të vendosi :

- Të japë statusin e refugjatit ;
- Të refuzojë statusin e refugjatit dhe të japë statusin e mbrojtjes plotësuese ;
- Të refuzojë statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese.



E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT



# TË DREJTAT E FËMIJËVE

---

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT

# TË DREJTAT E FËMIJËVE

Të gjithë fëmijët kanë të drejta të veçanta, të cilat i quajmë të drejtat e fëmijës. Konventa është hartuar pikërisht për të drejtat e fëmijës që ato të mund ti ushtrojnë këto të drejta. Shumica e shteteve në botë, e përfshirë Belgjika, e kanë firmosur këtë konventë dhe angazhohen kështu që fëmijët të përfitojnë efektivisht nga të drejtat e tyre.

Njëra nga të drejtat e fëmijës është e drejta për t'u dëgjuar. Kjo do të thotë që ti ke të drejtë të shprehesh në kuadrin e një vendimi të rëndësishëm që të përket ty gjithashtu. Ata mund të shprehen në menyrën që preferojnë : duke folur, duke vizatuar, duke shkruar ose në ndonjë menyrë tjetër.

**Është një e drejtë, por nuk është një detyrë, në parim, nuk është aspak e nevojshme. Ne presim nga ju që të na tregoni problemet që keni pasur për fëmijët që ju shoqërojnë gjatë intervistës tuaj personale në CGRA. Fëmijët që ju shoqërojnë pra nuk janë të detyruar të flasin në CGRA.**

Fëmijët që ju shoqërojnë mund të kërkojnë një intervistë në CGRA nëse dëshirojnë personalisht. Nëse nuk dëshirojnë ta bëjnë, vendimi që do merret në dosjen tuaj nuk do të ketë ndikim. Meqë një intervistë në CGRA shkakton shumë stres, është e rëndësishme që fëmijët minorenë që ju shoqërojnë të vendosin vetë nëse duan apo jo të bëjnë një intervistë në CGRA.



**FËMIJËT QË JU  
SHOQËROJNË  
DËSHIROJNË GJITHASHTU  
TË FLASIN VETË PËR  
PROBLEMET DHE FRIKËN  
E TYRE**

---



## DUHET TË BËJNË ?

---

Në qoftë se një ose të gjithë fëmijët që ju shoqërojnë dëshirojnë të tregojnë vetë perse e kanë lëshuar vendin tuaj dhe nuk mund të kthehen atje, CGRA duhet të informohet. Preferohet që të bëhet me letër ose me e-mail jo më vonë se pesë ditë përpara datës së intervistës tuaj personale. Fëmijët që dëshirojnë të bëjnë një intervistë me CGRA, nuk mund të bejnë ata vetë kërkesën. Ju, avokati juaj, një mësues, një asistent social, një person i besueshëm, etj, mund ta bëni këtë letër ose me e-mail, ose ti telefononi shërbimit të Minorenëve të CGRA. Ju i gjeni të gjitha të dhënat dhe gjithashtu një kopje të letrës në fund të kësaj broshure.

## A FTOHET FËMIJA ÇDO HËRË PËR NJË INTERVISTË NË QOFTË SE AI E BËN KËRKESËN ?

---

Jo. Në bazë të dosjes administrative, CGRA verifikon në fillim nëse fëmija është në gjendje të bëjë një intervistë me bashkëpunëtorin e CGRA. Nëse CGRA mendon që fëmija juaj është shumë i vogël për të shpjeguar ai vetë arsyet e largimit të tij nga vendi, fëmija juaj do të marrë një letër për këtë temë. Nëse CGRA vendos të ketë një intervistë me fëmijën tuaj, edhe ky merr gjithashtu një letër. Aty do të jetë e shkruar vendi dhe dita ku fëmija juaj mund të diskutojë me një bashkëpunëtor të CGRA. Kjo letër mund të prezantohet në shkollë si justifikim për ditën e mungesës.



# INTERVISTA ME BASHKËPUNËTORIN E CGRA

---

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT

## KU DO TË SHVILLOHET INTERVISTA ME BASHKËPUNËTORIN E CGRA ?

---

Fëmijët që dëshirojnë të shpjegojnë vetë problemet e tyre ose arsyet që i ndalojnë të kthehen në vendin e tyre ju shoqërojnë në CGRA ditën e intervistës tuaj personale. Fëmijët presin në sallën e pritjes deri në fund të intervistës tuaj personale. Njëri nga prindërit qëndron afër fëmijëve derisa tjetri është në intervistën e tij personale. Në qoftë se jeni një prind i vetëm, fëmijët mund të presin gjithashtu përpara lokalit ose vendit ku bëhet intervista personale. Pasi që intervista me ju mund të zgjasi, është e preferuar të sillni diçka që fëmija juaj të ketë me çfarë të merret gjatë kohës së pritjes. Posa të mbarojë intervista e juaj personale, do të filloj intervista e fëmijëve që ju shoqërojnë dhe të cilët kanë kërkuar të dëgjohen. Ju duhet të qëndroni në dhomë e pritjes gjatë intervistës.

Në rast të jashtëzakonshëm, nëse për arsye praktike, nuk është e mundur për CGRA ti dëgjojnë fëmijët të njëjtën ditë, kjo intervistë do të bëhet një ditë tjetër.

# SI ZHVILLOHET INTERVISTA E FËMIJËS TUAJ ME BASHKËPUNËTORIN E CGRA ?

---

Intervista e fëmijës tuaj me një bashkëpunëtor të CGRA nuk zgjat shumë në përgjithësi. Kohën më të shumtë, zgjat një gjysëm ore. Bashkëpunëtori i CGRA do ta dëgjojë fëmijën tuaj. Fëmija juaj mund ti tregojë atij atë që ka ndodhur dhe përse nuk ka dëshirë të kthehet në shtetin tuaj të origjinës. **Kjo bisedë do bëhet veç në lidhje me problemet dhe frikën e fëmijës tuaj dhe jo për problemet tuaja.** Ju e keni rastin në intervistën tuaj personale ti shpjegoni në detaje arsyet për të cilat ju kërkoni mbrojtje ndërkombëtare dhe arsyet që i përkasin fëmijëve minorene që ju shoqërojnë. Fëmija duhet të thotë veç atë që ka dëshirë të thotë. Për këtë biseda me fëmijën nuk krahasohet me intervistën tuaj personale : fëmija ftohet që të tregojnë lirshëm atë që do. Numri i pyetjeve është i kufizuar ; qartësime nuk kërkohen veç në rast nevojë. Fëmija juaj nuk është i detyruar ti pergjigjet pyetjeve dhe mund të thotë gjithashtu që nuk e di përgjigjen.

## KUSH ËSHTË PREZENT NË INTERVISTË ?

---

Intervista zhvillohet ndërmjet bashkëpunëtorit të CGRA dhe fëmijës minorene. Në parim, ju nuk mund të jeni prezent gjatë kësaj interviste. Një përkthyes është prezent për të siguruar që fëmija dhe bashkëpunëtori i CGRA të kuptohen mirë. Përkthyesi nuk mund të komunikojë përmbajtjen e intervistës as juve dhe as personave të tjerë. Përkthyesi nuk ndërhyr në asnjë moment në vendimin përfundimtar.

Fëmija që ka dëshirë të ketë një intervistë në CGRA mund të marrë me vehte vetëm një person të besueshëm. Nuk mund të jenë pjestarët e familjes së fëmijës. Përsoni që e shoqëron fëmijën si një person i besueshëm duhet nga profesioni i tij, të jetë i specializuar në ndihmën e personave ose në të drejtën e të huajve, dhe të ketë lidhje me fëmijën. Mund të jetë për shëmbull mësuesja, një psikolog/e ose një asistent/e social/e. Preferohet që të shenohet në letër ose në e-mail/in e adresuar CGRA kush do ta shoqëroj fëmijën tuaj në interviste. Bashkëpunëtori i CGRA megjithatë mund të vendos të mos autorizoj këtë person të marrin pjesë në intervistë. Përsoni që shoqëron fëmijën nuk mund të bëjë deklaratat në emër të fëmijës dhe as në emrin tuaj.

Gjatë intervistes, fëmija juaj duhet të shoqërohet nga një **avokat. Prezenca e një avokati është e detyruar.** Mund të jetë avokati juaj ose një avokat tjetër. Avokati i përmbahet sekretit profesional.

Personi i besueshëm dhe avokati mund të bëjnë vrejthe në fund të intervistës me fëmijën tuaj.

## A NDJEKIM GJITHMONË DËSHIRAT E FËMIJËVE?

---

Jo. Në vendim, CGRA merr parasysh mendimin e fëmijës, por kjo nuk do të thotë që është dakord ose do të ndjekin mendimin e fëmijës. CGRA merr një vendim në bazë të gjitha informacioneve të marrura.

Deklaratat tuaja janë, në parim, më të rëndësishmet për vlerësimin e kërkesës tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Ne nisemi nga parimi që ju mbron gjithashtu interesat e fëmijëve tuaj minorene dhe që ju tregoni problemet eventuale që këto fëmijë kanë pasur dhe mund të kenë.

## NJË INTERVISTË E MËVONSHME ËSHTË E MUNDUR

---

Është e mundur që fëmija të ketë një ose shumë arsye të tjera nga ato që ju keni përmendur dhe që e ndalojnë të kthehet në vendin e tij të origjinës. Ndodh **shumë rradhë**. Në qoftë se rastet që fëmija përmend duken veçanërisht të rënda, CGRA mund ta thërrasi fëmijën tuaj për një intervistë të dyte. Në këtë rast, thërrasi fëmijën e rëndësishme që fëmija të shkojë efektivisht në këtë intervistë. Kjo intervistë bëhet nga një bashkëpunëtor i CGRA, i specializuar në trajtimin e kërkesave të mbrojtjes ndërkombëtare që i përkasin fëmijëve.

Ju prap nuk mund të jeni prezent. Gjatë kësaj interviste të dyte, fëmija duhet të jetë i shoqëruar nga një avokat dhe në qoftë se dëshiron, një person të besueshëm. Në qoftë se bëhet një intervistë e dytë, avokati që merr pjesë duhet të jetë një tjetër dhe jo i juaji. Avokati atëherë merr një letër nga CGRA për këtë

temë. Avokati juaj ose asistenti social mund t'ju ndihmojnë të gjeni një avokat tjetër për fëmijën që është i thirrur për një intervistë të dytë. Nëse, mbas shqyrtimit shtesë të CGRA, është vendosur që ju mos të informoheni për deklaratat e fëmijës tuaj, këto do t'i bashkangjiten dosjes tuaj administrative, ju nuk mund të kërkonti që ti konsultoni shënimet e intervistës së fëmijës tuaj. **Në qoftë se fëmija juaj bën deklaratat që janë të kundërta me deklaratat e juaja, ato nuk do të përdoren kundra jush.**

## FËMIJA JUAJ ËSHTË I THIRRUR PËR NJË INTERVISTË NË KOMISARIAT NDËRSA AI NUK E KA BËRË KËTË KËRKESË

---

Është e mundur që CGRA, mbas intervistës personale të bërë me ju, vendos në mënyrë të jashtëzakonshme, ti japë njërit ose disa fëmijëve minorene që ju shoqërojnë mundësinë të shpjegojnë atë që ju ka ndodhur atyre në vendin tuaj dhe se cila është frikë që ata kanë në rast të kthimit. Kjo është e mundur nëse, për shembull, ju keni përmendur raste specifike në lidhje me një nga fëmijët që ju shoqërojnë. Fëmija juaj merr atëherë një letër thirrje për një intervistë në CGRA. Gjatë kësaj interviste, fëmija duhet të jetë i shoqëruar nga një avokat dhe eventualisht nga një person i besueshëm. Ju nuk mund të merrni pjesë në intervistë. Fëmija që thirret për një intervistë, nuk është i detyruar të marr pjesë në intervistë. Nëse fëmija juaj preferon që mos ta bëjë, kjo nuk do të ketë asnjë pasojë mbi vendimin e marrë në lidhje me familjen tuaj.



# VENDIMI



E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT



# VENDIMI

---

Pasi që bashkëpunëtori i CGRA ti mbledh të gjitha informacionet e nevojshme, ai paraqet vendimin e tij. Bëhet fjalë në parim për një vendim të vetëm për ju dhe familjen tuaj. Në raste të jashtëzakonshme, është e mundur që të merret një vendim tjetër për fëmijët minorenë që ju shoqërojnë. Ju e keni gjithmonë mundësinë të bëni një ankesë kundra vendimit të CGRA.

Këshilli i Ankesave për të huajt (CCE) vendos mbi ankesat e bëra kundra vendimeve të azilit negativ të CGRA. Ka procedura të ndryshme të ankesave sipas llojit të vendimit. CCE merr vendime që përmbajnë një motivim të detajuar.

Lexoni më shumë në : <https://www.cgrs.be/en/international-protection/appeals-procedures>



E DREJTA PER T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT

# **Një pasqyrë skematike e një bisede CGRA**



# INTERVISTË ME CGRA

1

TI KE DESHIRE TE  
SHPREHESH



NUK ËSHTË DETYRUAR



PRINDËRIT OSE KUJDESTARI  
NUK JANË PREZENT  
GJATË INTERVISTËS

I/E SHOQËRUAR NGA :

NUK JANË PËRDORUR  
DEKLARATA TË KUNDËRTA  
ME ATO TË PRINDËRVE

INTERVISTË E SHKURTËR

AVOKAT

PERSON I BESUESHËM  
EVENTUALISHT



**NJË VENDIM  
I VETËM DHE  
I NJËJTI PËR  
FAMILJEN**

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT

2

**CGRA TE FTON  
PER INTERVISTE**



NUK ËSHTË DETYRUAR



PRINDËRIT OSE KUJDESTARI  
NUK JANË PREZENT  
GJATË INTERVISTËS

I/E SHOQËRUAR NGA :

NUK JANË PËRDORUR  
DEKLARATA TË KUNDËRTA  
ME ATO TË PRINDËRVE

INTERVISTË MË E GJATË,  
ME PYETJE OBJEKTIVE



AVOKAT

PERSON I BESUESHËM  
EVENTUALISHT

**NJË VENDIM I VETËM  
DHE I NJËJTI PËR  
FAMILJEN, NJË  
MUNDËSI E VEÇANTË  
PËR NJË VENDIM  
INDIVIDUAL**

E DREJTA PËR T'U DËGJUAR UDHËZUES PËR PRINDËRIT

# Kontaktet

---

## **COMMISSIONER GENERAL FOR REFUGEES AND STATELESS PERSONS**

Rue Ernest Blerot 39  
1070 ANDERLECHT  
Telefon +32 (0)2 205 51 11  
Faks +32 (0)2 205 51 15  
E-mail: [cgvs.info@ibz.fgov.be](mailto:cgvs.info@ibz.fgov.be)  
Faqja e internetit: [www.cgvs.be](http://www.cgvs.be)

## **CELULA PËR TË MITURIT**

CGRA ka një kordinatore për azilkërkuesit e mitur.

Ajo është e informuar për çdo gjë në lidhje me trajtimin e kërkesave për azil për fëmijët e mitur nën mbikëqyrje. Ajo ndjek nga afër dosjet e tyre.

Për çdo pyetje ose vërejtje, prindërit dhe kujdestarët mund t'i drejtohen kordinatores për të miturit.

E-mail: [CGRA-CGVVS.Mineurs@ibz.fgov.be](mailto:CGRA-CGVVS.Mineurs@ibz.fgov.be)

Telefon +32 (0)2 205 53 06  
Faks +32 (0)2 205 50 05

Si instancë qendrore dhe e pavarur për azil, CGRA është në kontakt me shumë partnerë belg, evropianë dhe ndërkombëtarë.

Lexo më shumë në : [www.cgrs.be/en/partners](http://www.cgrs.be/en/partners)

**Dëshiron të dish më shumë rreth CGRA?**



**[www.cgra.be](http://www.cgra.be)**



**@cgvs\_cgra**



## OFFICE OF THE COMMISSIONER GENERAL FOR REFUGEES AND STATELESS PERSONS

Rue Ernest Blerot 9  
1070 BRUSSELS



02 205 51 11



cgra.info@ibz.fgov.be



www.cgra.be



@cgvs\_cgra